



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 579/19 Prot.

Tiranë, më 16.02 2023

VENDIM
Nr. 30 datë 16.02 2023

“PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN AKADEMIK
NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR
ME UNIVERSITETIN “LUARASI””

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, neni 3, pika 4, gërma “c” si dhe në Statutin e Universitetin të Sporteve të Tiranës neni 20, pika “s”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **16/02/2023**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunimin akademik në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor me **Universitetin LUARASI**.
2. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





Universiteti i Sporteve të Tiranës



Universiteti "Luarasi"

Nr. prot._____,

datë ___ / ___ / 2023

Nr. prot._____,

datë ___ / ___ / 2023

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN AKADEMIK
NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR**

Ndërmjet

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS (UST), përfaqësuar nga Rektori Prof.Dr.
Agron KASA**

dhe

UNIVERSITETIT LUARASI, përfaqësuar nga Rektori Prof.Dr. Ethem RUKA

Duke konsideruar se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave dhe njohurive, si dhe ofrimi i shërbimeve midis dy institucioneve janë reciprokisht të dobishme për përparimin social dhe kulturor, të dy institucionet e sipër përmendura bien dakord të bashkëpunojnë dhe të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi bazuar në klauzolat e mëposhtme

**Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i një kuadri për bashkëpunim midis **UST** dhe **LUARASI** në fushën e shkencës, teknologjisë dhe edukimit midis të dy palëve. Marrëveshja ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit akademik, shkencor dhe kulturor, si dhe shkëmbimin e stafit akademik, studiuesve dhe studentëve, punëve kerkimore akademike dhe të projekteve midis dy institucioneve.



Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Fushat kryesore të bashkëpunimit në kuadër të kësaj marrëveshje do të janë:

- a) Shkëmbimi i stafit akademik për procesin mësimor;
- b) Shkëmbimi i pedagogëve, studiuesve dhe studentëve në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore;
- c) Inkurajimin, mbështetjen dhe implementimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
- d) Promovimin, mbështetjen dhe zbatimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare dhe botime në fusha me interes të përbashkët);
- e) Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f) Shkëmbimin e librave, botimeve shkencore, programeve të studimit, projekteve akademike dhe informacioni tmbi kurset, konferencat, seminaret dhe bazat e tëdhënave me interes të përbashkët.
- g) Nënshkrimin e kontratave të përbashkëta të botimit në përputhje me buxhetin e dy institucioneve, nëse ka një interes të përbashkët për publikimin e rezultateve të kerkimit të mbuluara në këtë Marrëveshje bashkëpunimi;
- h) Shkëmbimin e përvojës në lidhje me menaxhimin e institucionit.

Neni 3

Të dy universitetet bien dakord që zbatimi i aktiviteteve të mësipërme do të kryhet në varësi të burimeve dhe potentialit të disponueshëm nga secili institucion. Për detajet e bashkëpunimit sipas nenit 2 dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes, secila palë duhet të caktojë një person kontakti si më poshtë:

- Personat kryesorë të kontaktit për **Universitetin e Sporteve të Tiranës**
 - Koordinatori Akademik: _____
 - Koordinatori Administrativ: MSc. Safiola ÇARÇANI, Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë, Publin dhe Studentët, Tel: +355 67 4091443, e-mail: sshabanaj@ust.edu.al
- Personat kryesorë të kontaktit për **Universitetin Luarasi**
 - Koordinatori Akademik: Prof. Asoc. Dr. Ani Sharko anni.dasho@luarasi-univ.edu.al
 - Koordinatori Administrativ Msc. Arsejda Gjyli arsejda.gjyli@luarasi-univ.edu.al



Neni 4

- 4.1 Secili prej rasteve të bashkëpunimit të përmendur në Nenin 2 të marrëveshjes, do të kërkojë hartimin e një Marrëveshjeje Specifike përmes së cilës do të identifikohen qëllimet dhe mjetet e zbatimit të saj. Propozimet specifike do t'i nënshtronhen aprovimit nga autoriteti kompetent me vendimin e secilit universitet.
- 4.2 Marrëveshjet specifike të përfshira në këtë Marrëveshje do të shtohen si anekse.
- 4.3 Marrëveshjet specifike në lidhje me hulumtimin dhe projektet e mësimdhënies mund të mbulojnë aspektet e mëposhtme:
 - a) Përkufizimi i objektivit që do të ndiqet.
 - b) Përshkrimi i planit të veprimit, përfshirë fazat e ndryshme të projektit dhe kronologjinë e zhvillimit.
 - c) Buxheti i përgjithshëm dhe burimet njerëzore dhe materiale që nevojiten për programin/aktivitetin në fjalë, duke specifikuar kontributet e secilës palë.
 - d) Rregulloret për koordinimin, ekzekutimin dhe monitorimin e projektit.
 - e) Emrat e personave, një për secilën palë, të cilët do të jenë përgjegjës për ekzekutimin e marrëveshjeve specifike.
 - f) Pajisjet e siguruara nga secila palë dhe qëllimi i përdorimit të tyre.

Neni 5 Mekanizmat dhe format e financimit

Burimet financiare të aktiviteteve sipas kësaj marrëveshje do të përcaktohen qartë në marrëveshjet specifike. Nëse bien dakord, të dy universitetet do të sigurojnë, brenda mundësive të tyre dhe projekteve specifike, burime financiare dhe forma të tjera të mbështetjes për studentët dhe profesorët që marrin pjesë në shkëmbime.

Neni 6 Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë dhe për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet e tjera specifike të arritura ndërmjet palëve do të bëhen diskutime paraprake. Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet ose revokohet në çdo kohë pas konsultimit dhe mirëkuptimit reciprok midis dy universiteteve.



Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me fryshtë e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 7
Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Afati i marrëveshjes mund të shtyhet nëse palët janë dakort për rinovimin e saj me shkrim. Në rast të mos rinovimit, palët do të njoftojnë me shkrim 3 (tre) muaj para përfundimit të marreveshjes.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën pas nënshkrimit të tij nga të dy palët. Kjo marrëveshje është nënshkruar në dy kopje origjinale.

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST)

Rektori

Prof. Dr. Agron KASA

Universiteti Luarasi

Rektori

Prof. Dr. Ethem RUKA